

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË PROKURORISË SË PËRGJITHSHME PËR VITIN 2024

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke mbajtur në konsideratë rolin e prokurorisë në ushtrimin e ndjekjes penale, hetimin, përfaqësimin e akuzës në gjyq, ekzekutimin e vendimeve penale dhe kryerjen e detyrave të tjera të ngarkuara me ligj;

Duke vlerësuar rëndësinë e raportimit të Prokurorit të Përgjithshëm në Kuvend për gjendjen e kriminalitetit, për zbatimin e rekomandimeve të Kuvendit dhe të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit dhe për efektivitetin e ndjekjes penale;

Duke vlerësuar rolin e Prokurorit të Përgjithshëm në nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme për prokurorët e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, për oficerët e Policisë Gjyqësore, si dhe për mbikëqyrjen e zbatimit të tyre;

Duke vlerësuar angazhimin në zbatimin e rekomandimeve të Grupit të Shteteve të Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit (GRECO) dhe përmbushjen e detyrimeve për realizimin e Planit të Veprimit ICRG/FATF;

Në vlerësim të raportit të paraqitur nga Prokuroria e Përgjithshme mbi gjendjen e kriminalitetit për vitin 2024, në përmbushje të rekomandimeve të dhëna dhe debatit të zhvilluar rreth tij konstaton:

Është rritur angazhimi institucional për ndjekjen penale të veprave që prekin interesin publik dhe sundimin e ligjit, përmes hetimeve të nisura kryesisht dhe rritjes së cilësisë në hetim.

Janë ndërmarrë hapa pozitivë për zbatimin e standardeve të mbrojtjes së të miturve dhe viktimave të dhunës në familje, përfshirë bashkëpunimin me institucionet mbrojtëse dhe përdorimin e masave alternative të sigurimit.

Është avancuar bashkëpunimi me autoritetet e huaja përmes strukturave ndërkombëtare si Eurojust dhe janë zhvilluar operacione të përbashkëta për goditjen e veprimtarisë kriminale transnacionale.

Është demonstruar përkushtim në zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritetit në Bashkimin Evropian, veçanërisht në fushën e luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Janë marrë masa për përmirësimin e infrastrukturës teknologjike, përfshirë zhvillimin e sistemit PRESTO dhe përgatitjen për implementimin e sistemit të integruar të menaxhimit të çështjeve.

Janë ndërmarrë hapa konkretë për bashkëpunim të zgjeruar me autoritetet e huaja në luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikut ndërkombëtar, përfshirë nënshkrimin e marrëveshjeve dhe krijimin e grupeve të përbashkëta hetimore në bashkëpunim me Eurojust dhe Europol.

Ka pasur angazhim në përgatitjen e raporteve dhe përgjigjeve institucionale për organizmat ndërkombëtarë, në kuadër të procesit të integritetit dhe monitorimit ndërkombëtar, duke treguar një qasje më të organizuar dhe të koordinuar në zbatimin e planit të veprimit të FATF/ICRG dhe rekomandimeve të GRECO-s.

Është konsoliduar funksioni i Prokurorit të Përgjithshëm në orientimin e politikës penale, përmes nxjerrjes së udhëzimeve të përgjithshme dhe rekomandimeve për uniformizimin e praktikës, duke synuar përmirësimin e cilësisë së ndjekjes penale dhe mbikëqyrjen e zbatimit nga prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm.

Kuvendi i Shqipërisë rekomandon që Prokuroria e Përgjithshme për vitin 2025 të angazhohet veçanërisht edhe në këto drejtime:

1. Të intensifikohen hetimet proaktive dhe hetimet që nisin kryesisht nga prokuroria, duke forcuar rolin aktiv të prokurorit dhe duke rritur përdorimin e teknikave të posaçme hetimore.

2. Të zgjerohë përdorimin e hetimeve financiare dhe analizës pasurore, duke garantuar trajnimin e strukturave përkatëse, përdorimin sistematik të instrumenteve të ndjekjes së pasurisë dhe bashkëpunimin me agjencitë e tjera ligjzbatuese përgjegjëse, gjithashtu, në këtë fushë.

3. Të zbatohen në mënyrë më të gjerë dhe të strukturuar masat alternative të sigurimit për raste me rrezikshmëri të ulët shoqërore, duke respektuar parimin e proporcionalitetit në masat kufizuese të lirisë.

4. Të përgatitet një analizë mbi masat e sigurisë të marra në këto 5 vjet (2021–2025), politikat e ndjekura, problematikat e konstatuara dhe masat e nevojshme për reflektim në praktikën e vendeve evropiane në këtë fushë dhe standardet e rekomanduara nga KiE, BE, GJEDNJ, Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata e Lartë.

5. Në bashkëpunim me SPAK-un dhe KQZ-në të zhvillojnë një analizë të përbashkët për zbatimin e Strategjisë për Hetimin dhe Parandalimin e Krimeve Zgjedhore për zgjedhjet e vitit 2025 dhe masat ligjore e institucionale që mund të ndërmerren për të garantuar integritetin e proceseve zgjedhore dhe për të parandaluar e ndëshkuar çdo shkelje të ligjit në këtë fushë.

6. Të vijojë me tej zhvillimi dhe përfundimi i sistemit e-PRESTO për administrimin elektronik të regjistrave proceduralë dhe përfitimin e statistikave në kohë reale me të dhëna gjithëpërfshirëse, të hollësishme dhe të besueshme.

7. Të vijojë puna për funksionalizimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve, si dhe ndërlidhjes duke bashkëpunuar me Qendrën e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

8. Të hartohet një strategji kombëtare për komunikim publik dhe transparencë, me fokus publikimin periodik të statistikave dhe treguesve kryesorë, edukimin përmes fushatave mediatike për të drejtat e viktimave dhe transparencën mbi trajtimin e çështjeve me interes të lartë publik.

9. Të publikohet strategjia afatmesme e institucionit dhe të raportohet periodikisht për nivelin e zbatueshmërisë së saj.

10. Të formalizohet një mekanizëm bashkëpunimi i vazhdueshëm me ILD-në dhe KLP-në për të adresuar problematikat e konstatuara, për të ndarë të dhëna dhe praktika të mira bashkëpunimi, për forcimin e integritetit dhe përgjegjshmërisë në detyrë të prokurorëve.

11. Të vijojë intensifikimi i masave për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, të miturve dhe grave, përmes koordinimit të veçantë ndërinstitutional, trajnimeve dhe zbatimit të masave mbrojtëse.

12. Të përmirësojë cilësinë e hetimeve për veprat penale që prekin grupet vulnerabël, me theks të veçantë të dhuna me bazë gjinore dhe dhuna digjitale, si dhe të bashkëpunojë për amendimet e nevojshme ligjore në këtë drejtim.

13. Të vlerësohet mundësia për ngritjen e një njësie të specializuar brenda prokurorisë për luftën kundër krimit kibernetik, duke pasur në fokus rritjen e kapaciteteve dhe përdorimin e teknologjive të avancuara.

14. Të rritet bashkëpunimi ndërkombëtar për të forcuar luftën kundër krimit të organizuar, duke përfshirë bashkëpunimin e vazhdueshëm me shtetet anëtare dhe agjencitë e BE-së (përfshirë Europolin, EMPACT dhe Eurojust).

15. Të vijojë zbatimi i rekomandimeve të BE-së duke intensifikuar bashkëpunimin me agjencitë e BE-së (Eurojust, Europol, OLAF) dhe vendet anëtare për ndjekjen e çështjeve transnacionale dhe duke përmbushur plotësisht rekomandimet e progresraportit të BE-së, GRECO-s dhe MONEYVAL-it.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miraturar në datën 30.10.2025.